



**Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë i Universitetit të
Prishtinës “Hasan Prishtina”**

Plani Strategjik 2018 – 2022

Prishtinë, Tetor 2018

Plani Strategjik 2018 – 2022

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”

Ky plan strategjik është përkrahur nga Programi për Lidërsipin Transformues – Bursat dhe Partneritetet. Programi financohet nga USAID dhe MEST dhe implementohet nga organizata World Learning.



Në partneritet ndërmjet Universitetit të Minesotës dhe Fakultetit Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës



"Ky Plan Strategjik është bërë i mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara. "

Përmbajta

Historiku i fakultetit

Vlerësimi i situatës aktuale

Analizë e tregut

Vizioni strategjik

Misioni dhe Vizioni

Vlerat mbi të cilat punojmë

Qëllimet

Strategjitë dhe Veprimet

Plani i Përgjithshëm Operacional (Annex A)

Plani Operacional për 5 vite (Annex B)

Shkurtesat

UP	- Universiteti I Prishtinës
FBV	- Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
BSc	- Baçelor i Shkencave
MSc	- Master i Shkencave
DMV	- Doktor i Mjekësisë Veterinare
IBV	- Instituti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
ZKPS	- Zyra për Kërkime dhe Projekte të Sponsorizuara
QPM	- Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie
QZHK	- Qendra për Zhvillimin e Karrierës
NSH	- Nisma Shkencore Hulumtuese
BKI	- Bordi Këshillues për Industri
SEMS	- Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve

Historiku i Fakultetit

Fakulteti i Bujqësisë është themeluar më 26 gusht 1973 me vendim të Asamblesë së Universitetit të Prishtinës, si rezultat i rritjes së nevojës për persona të arsimuar me kualifikime të larta, gjë që do të rezultonte në zhvillimin më të shpejtë të bujqësisë të Kosovës. Në vitin 2001 u krijua departamenti i mbrojtjes së bimëve. Në vitin 2006, Fakulteti i Bujqësisë u riemërua në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, i cili u miratua nga Senati i Universitetit të Prishtinës.

Rreth dy deri tre dekada prapa, brenda Fakultetit të Bujqësisë në Prishtinë, u integruan disa institute dhe organizata rajonale, duke përfshirë Institutin Bioteknologjik të Pejës (Pejë), Institutin e Blegtorisë dhe Veterinarisë (Prishtinë), Fidanishten Bujqësore (Pejë), Institutin për Ekonomi dhe Zhvillim (Fushë Kosovë) dhe Shërbimit të Përbashkët të Shërbimit të Komunitetit (Prishtinë).

Ky integrim lejoi dhe inkurajoi hulumtimin e aplikuar të orientuar drejt tregut, e që ishte si nevojë e rrethanave shoqërore, në Fakultetin e Bujqësisë, në atë kohë, duke çuar në një numër në rritje të studentëve të rinj vit pas viti.

Deri më tani janë diplomuar gjithsej 1326 studentë nga të gjitha fushat në FBV (Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë) përmes kurrikulave të mësuara në gjuhën shqipe. Në vitin 2001, Senati i Universitetit të Prishtinës miratoi plane mësimore bazuar në Deklaratën e Bolonjës për Baçelor dhe Diplomë Master. Bazuar në nevojën për zhvillimin dhe avancimin e njohurive shkencore për gjeneratat e reja me profile të ndryshme dhe duke pasur parasysh edhe profilin e Mjekësisë Veterinare, Këshilli i Fakultetit dhe stafi i tij akademik kanë propozuar riemërimin e Fakultetit të Bujqësisë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë. Propozimi është aprovuar në vitin 2006 nga Senati i UP dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Në vitin akademik 2007/08 në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë kanë studiuar 761 studentë në programe universitare, ndërsa Fakulteti gjithashtu ka planifikuar të fillojë studimet master për 10 studentë në programet: Lavërtari-Perimtari, Shkencat e Aplikuara në Zootekni, Pemëtari -Vreshtari dhe Agroekonomi.

Aktualisht janë përfshirë më shumë se dyzetë mësime dhe asistentë në procesin mësimor në orar të plotë (të rregullt), 20 punonjës akademikë të angazhuar nga fakultetet e tjera të Universitetit të Prishtinës dhe rreth 30 bashkëpunëtorë të jashtëm. Zbatimi i kurrikulës filloi në vitin akademik 2007/08, ndërsa kurrikulat e mëparshme në programet baçelor dhe master janë botuar në deklaratën e 2005/06.

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV) përbëhet nga departamentet e mëposhtme:

1. Agroekonomi
2. Mjekësi Veterinare
3. Bioteknologji në zootekni
4. Lavërtari me perimtari
5. Mbrojtja e bimëve
6. Pemëtari - vreshtari
7. Teknologji ushqimore

FBV ofron programe studimi si vijon:

1. Ekonomia e Bujqësisë (BSc)
2. Ekonomia e bujqësisë dhe ushqimit (MSc)
3. Mjekësia veterinare (DMV)
4. Menaxhimi i biznesit në zootekni (BSc)
5. Shkencat e aplikuara në zootekni (MSc)
6. Prodhimtaria bimore (BSc)
7. Lavërtari me perimtari (MSc)
8. Mbrojtja e bimëve – Fitomedicinë (MSc)
9. Pemëtari, vreshtari me hortikulturë (MSc)
10. Teknologji ushqimore me bioteknologji (BSc)
11. Shkenca e ushqimit (MSc, në pritje të akreditimit)

Vlerësimi i situatës aktuale

Përderisa fakulteti është angazhuar të ofrojë programe më të mira akademike, është vërejtur një rënie e interesit në disa nga programet akademike si Menaxhimi i biznesit në Zootekni, ndërkohë që disa programe të tjera kanë pasur rritje të konsiderueshme në aplikimet e pranimit si programi studimor Teknologji Ushqimore me Bioteknologji.

Ky trend në ndryshim në programet e FBV-së shihet si një sinjal i një tregu në ndryshim në Kosovë dhe nevojat e tregut reflektojnë në interesin e programeve të ndryshme akademike. Deri më tani, nuk ka pasur ndonjë hulumtim të rëndësishëm mbi mënyrën e trajtimit të ndërprerjes së programeve akademike që FBV-ja ofron, bazuar në ndryshimin e nevojave të tregut.

Rritja e kërkesës për studime në nivelin master ka qenë e evidente gjatë dy viteve të fundit. Përderisa ekonomia e Kosovës rritet, nevoja për bujqësi dhe ekspertizë veterinare është rritur ndjeshëm, ndërsa FBV nuk ka qenë në gjendje të plotësojë nevojat e tregut me kapacitetet aktuale, qoftë kapacitetet njerëzore apo edhe ato fizike.

Kjo është vlerësuar duke zhvilluar fokus grupe me studentë, profesorë, akterë të sektorit privat si dhe një studim më të hollësishëm përmes pyetësorëve digjital.

Programet aktuale master nuk mund të përmbushin nevojat e tregut të Kosovës, ndërsa programet e reja master janë të domosdoshme për të qenë në gjendje që FBV të konkurroje me fakultetet tjera rajonale dhe globale.

Mungesa e burimeve, si ato të pajisjeve laboratorike, stafi i pamjaftueshëm (akademik dhe administrativ), infrastruktura fizike dhe autonomia ligjore kanë kufizuar FBV-në në përpjekjet për të përmirësuar gjendjen. Këto çështje janë diskutuar në detaje gjatë punëtorisë dy-ditore të mbajtur në Janar 2018.

Ky plan strategjik gjithashtu është në përputhshmëri me "Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës 2017 - 2019" i cili në shumë pjesë e mbështetë duke ofruar

një mundësi unike për të vendosur një shembull të koordinimit të suksesshëm në mes të menaxhimit qendror të UP-së dhe përpjekjeve të fakultetit.


Brenda programit Horizont 2020, siguria ushqimore dhe bujqësia e qëndrueshme shihen me prioritet të lartë për sfidat me të cilat do të ballafaqohet shoqëria jonë. Prodhimi ushqimor i qëndrueshëm është i nevojshëm për sektorët e vegjël të bujqësisë. Proceset e reja të prodhimit të ushqimit do të paraqesin një mundësi për ngritjen e investimeve kërkimore në të ardhmen.

FBV do të udhëheqë këto iniciativa dhe duhet të jetë në gjendje të ofrojë zgjidhje për sfidat mjedisore dhe t'i përgjigjet me sukses nevojës së Kosovës për praktika bujqësore të pastra, të qëndrueshme dhe ekologjikisht miqësore.

Analiza e Tregut

Kosova njihet si një nga vendet më rurale në Evropën Juglindore, ku 60% e popullsisë jeton në zonat rurale. Shumica e këtyre njerëzve janë të angazhuar në një lloj aktiviteti bujqësor, ndërsa gjithsej, bujqësia punëson rreth 30% të fuqisë punëtore, kryesisht në aspektin joformal. Përveç kontributit të këtij sektori në punësim, bujqësia është një kontribuues i rëndësishëm në BPN-në e vendit. Në vitin 2016, bujqësia kontribuoi me 10.4% ndaj BPV-së së vendit, ndërsa gjatë një periudhe nëntëvjeçare (2008-16) ky sektor ka kontribuar me një mesatare vjetore prej rreth 612 milion euro në totalin e BPV-së së Kosovës.


Figura 3.0 – Kontributi i bujqësisë në Bruto Produktin Vendor në € 2008-2016 (në 000)



Në vitin 2015, prodhimi i kulturave bujqësore ishte kontribuuesi më i madh në sektorin e bujqësisë me një vlerë të prodhimit prej 342 milionë euro, e ndjekur nga blegtoria me 279 milionë euro dhe shërbime bujqësore dhe aktivitete sekondare me 19 milion dhe 8 milion euro. Kjo vlerë e kontributit u realizua në një sipërfaqe totale të tokës së shfrytëzuar bujqësore prej mbi 413 mijë hektarë, të shfrytëzuara nga 130,775 ekonomi familjare bujqësore. Regjistrimi bujqësor i vitit 2014 gjithashtu tregoi se këto familje bujqësore kanë 261,689 gjedhe, 183,584 dele dhe 28,430 dhi.

Megjithatë, krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, madhësia e fermave mbetet e vogël në Kosovë, duke përbërë mesataren më të ulët të madhësisë së fermës për shumicën e nën-sektorëve bujqësor. Në 2014, një ekonomi bujqësore në Kosovë ka kultivuar mesatarisht 3.2 ha sipërfaqe bujqësore (duke përfshirë edhe tokën e përbashkët).

Figura 4.0 – Pjesëmarrja e ha bazuar në madhësinë e fermës (%)



Siç mund të shihet edhe në figurën më lartë, pjesa më e madhe e tokës bujqësore, (mbi 48%) shfrytëzohet nga fermat me madhësi mesatare prej 1 deri në 5 ha. Sa i përket blegtorisë, fermat me gjedhe rrisin mesatarisht 3.9 gjedhe, ato me dele mesatarisht 64 dele, ndërsa ato me dhi 11.3 dhi.

Vizioni i FBV

FBV synon që të bëhet bartës i edukimit në bujqësi duke nxitur jetesë të qëndrueshme përmes mësimit të avancuar në shkencat e ushqimit, blegtorisë dhe në shkencat e mjedisit.

Misioni i FBV

Të edukojë dhe trajnojë gjeneratën e ardhshme të bujqësisë dhe fuqisë punëtore veterinare duke ofruar përsosmëri të mësimit dhe hulumtime në sigurinë ushqimore dhe në të gjitha fushat lidhur me shëndet të kafshëve, mjedisit dhe shëndetit njerëzor.

Vlerat mbi të cilat punojmë

Cilësia - Ne kërkojmë të përmirësojmë vazhdimisht cilësinë e mësimit dhe hulumtimit dhe stafit tonë në mënyrë që të ofrojmë mundësi më të mira arsimore për studentët tanë.

Kreativiteti dhe Inovacioni - Zbatimi i metodave të reja të mësimit dhe hulumtimit përmes qasjeve krijuese në mësimit dhe hulumtim.

Bashkëpunimi - Kontributi i të gjithëve është shumë i rëndësishëm. Bashkëpunimi është baza për sukses në fakultetin tonë. Projektet dhe programet ndërdisiplinore kërkimore do të kultivojnë frymën e bashkëpunimit.

Profesionalizmi - Ne vlerësojmë profesionalizmin në mësimit dhe kërkime, si dhe kërkojmë integritet nga fakulteti dhe studentët tanë.

Diversiteti - Fakulteti ynë ofron programe të ndryshme akademike dhe gjithashtu perspektiva të ndryshme në vendin e punës të vlefshëm për përsosmërinë kërkimore ndërdisiplinore.

Ky plan strategjik 5-vjeçar ka 7 qëllime

Qëllimi 1: Krijimi i një marrëdhënie dinamike me sektorin privat

Qëllimi 2: Ofrimi i programeve studimore në koordinim me nevojat e tregut

Qëllimi 3: Rekrutimi i stafit të shkëlqyeshëm dhe produktiv

Qëllimi 4: Rritja e cilësisë akademike dhe metodave inovative të mësimdhënies

Qëllimi 5: Vendosja e FBV-së si Fakultet Hulumtues

Qëllimi 6: Njohja e FBV si institucioni kryesor për qëndrueshmërinë mjedisore dhe jetesën e qëndrueshme

Qëllimi 7: Ndarja e Departamentit të Mjekësisë Veterinare në njësi akademike në vete.

Qëllimi 1: Krijimi një marrëdhënie dinamike midis FAV dhe sektorit privat

Objektivi 1: Nënshkrimi i deri 10 Memorandumeve Bashkëpunimi (MB) me kompanitë private si partnere strategjike për FBV-në deri më 2020.

Strategjia 1: *Themelimi dhe zhvillimi i IBV-së deri në fund të dhjetorit 2018.*

IBV brenda Fakultetit duhet të jetë funksional deri në fund të dhjetorit. Plani i biznesit tashmë është zhvilluar dhe duhet të përdoret si udhërrëfyes drejt krijimit të Institutit dhe shfrytëzimit të mundësive që paraqet ai. Fakulteti duhet të angazhohet për zhvillimin e Institutit duke caktuar hapësirën e nevojshme, qasjen në laboratorë dhe duke siguruar përfshirjen e studentëve në projektet akademike.

Veprimet:

- a. Caktimi i hapësirës së zyrës, së paku një dhomë që përshtatet për 3 punonjës deri në fund të dhjetorit 2018. Alokimi i hapësirës fizike do të përshejtojë zhvillimin e Institutit. Zyra duhet të jetë e arritshme për të gjithë anëtarët që kanë nevojë për hapësirë për zyre për të zhvilluar projekte;
- b. Përgatitja e një plani të marketingut për IBV-në. FBV duhet të krijojë një grup pune që do të përgatisë një plan marketingu për Institutin. Ato duhet të përfshijnë strategji se si të targetohen kompanitë private, palët e interesuara publike dhe burimet ndërkombëtare. Duhet të ketë një plan të qartë se si do të sigurojnë rrjedhën e duhur të informacionit ndërmjet menaxhmentit të FBV, organit drejtues të institutit dhe studentëve;
- c. Organizimi i sesioneve informative dhe pjesëmarrja në panairë bujqësore dhe veterinare. Një nga përgjegjësitë e Institutit është të promovojë shërbimet e tyre (specifikat e përfshira në Planin e Biznesit) dhe burimet që mund të shfrytëzojnë studentët, fakultetet dhe institucionet private ose publike. Sesionet informative të rregullta duhet të organizohen në ndërtesat e fakultetit me studentët rreth mundësive të ndryshme të projektit dhe nismave të ndryshme që nxënësit mund të përfshihen;

d. Nënshkrimi i 10 Memorandumeve të Bashkëpunimit (MB) me kompanitë private që janë me interes për marrëdhëniet midis FBV dhe sektorit privat. Këto MB duhet të përfshijnë mundësitë e bashkëpunimit dhe ofrimin e praktikës (internships) të rregullta në ato kompani. MB-të duhet të shërbejnë vetëm si një fillim i një bashkëpunimi më të ngushtë midis sektorit privat dhe fakultetit;

Strategjia 2: Organizimi i ngjarjeve në bashkëpunim me sektorin privat.

Veprimet:

- e. Themelimi i Bordit Këshillues për Industri (BKI) me pjesëmarrës nga fakulteti, IBV dhe partnerët strategjikë të sektorit privat;
- f. Caktimi i një kontakti (individit) që do të përqendrohet në forcimin e marrëdhënieve të fakultetit me sektorin privat dhe punimeve brenda kësaj industrie;
- g. Përgatitja e paketave të informimit për shërbimet që FBV dhe Instituti mund të ofrojnë për sektorin privat;
- h. Organizimi i sesioneve informuese dhe ftesa e aktorëve relevantë të sektorit privat dhe njerëzve me interes;

Objektivi 2: Rritja e burimeve laboratorike që mundësojnë ofrimin e shërbimeve më të nevojshme në treg.

Strategjia 1: Fillimi i procesit të akreditimit të laboratorëve deri në fund të tetorit 2019.

Gjendja aktuale e laboratorëve të FBV-së nuk i plotëson të gjitha standardet që kërkohen për të ofruar shërbime që do të rezultojnë me një kontribut të rëndësishëm për studentët dhe fakultetin, si dhe për institucionet private dhe publike.

Menaxhmenti i fakultetit duhet të fokusohet në sigurimin e fondeve të brendshme dhe të jashtme që mund të përdoren për pajisjen e laboratorëve me pajisje të reja të nevojshme. Në të njëjtën kohë, menaxhmenti i fakultetit duhet të sigurojë fillimin e

procesit të akreditimit për të gjitha pajisjet ekzistuese laboratorike. Shumica e shërbimeve që Instituti synon të ofrojë kërkojnë profilet e kontrollit të cilësisë dhe pa pasur të gjitha pajisjet e kalibruara dhe akredituara, fakulteti nuk mund të kryejë shumicën e shërbimeve të nevojshme në treg.

Veprimet:

- i. Punësimi i së paku 2 laborantëve deri në fund të vitit 2019. Këta laborantë do të jenë hapi i parë drejtë përdorimit të plotë të burimeve aktuale laboratorike. Ata gjithashtu do të jenë në gjendje të vlerësojnë më mirë nevojën për pajisje të reja dhe të vlerësojnë ato ekzistuese në mënyrë që të sigurojnë që secili laborator të plotësojë të gjitha kërkesat e dhëna nga organi i akreditimit. Në të njëjtën kohë, fakulteti mund të fillojë përfshirjen e studentëve në projekte të ndryshme hulumtimi që kërkojnë qasje laboratorike dhe ekspertizë të një laboranti për të kryer detyra specifike;
- j. Caktimi i IBV-së që të punojë ngushtë me të gjitha departamentet në zhvillimin e temave të ndryshme kërkimore që janë me interes të lartë për kontekstin lokal. Këto projekte kërkimore duhet të përfshijnë studentët dhe duhet të fokusohen në ndërtimin e marrëdhënieve me palët kyçe për të rritur praninë publike dhe për të vendosur besueshmërinë në komunitet;
- k. Shfrytëzimi i IBV-së për të promovuar nevojën për pajisje të avancuara laboratorike brenda UP. Ekziston një grand i veçantë që synon përmirësimin e kushteve të laboratorit brenda universitetit dhe FBV duhet të fokusohet në sigurimin e shpjegimeve të arsyeshme se pse laboratorëve të tyre duhet t'u jepet prioritet.

Qëllimi 2: Ofrimi i programeve studimore në koordinim me nevojat e tregut

Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë ka ndikuar në kurrikulat universitare në mbarë botën. Vetëm në dekadat e fundit, universitetet kanë paraqitur programe të reja sepse një teknologji e re ka krijuar një profesion të ri. Bizneset që kanë përdorur teknologjinë

kanë pasur një ndikim të madh dhe kanë nevojë për fuqi njerëzore për ta menaxhuar atë ndikim.

Përveç kësaj, rritja ekonomike ndikon në krijimin e kompanive të reja të cilat në kthim krijojnë vende të reja pune dhe profesione të ndryshme. Prandaj, universitetet duhet të krijojnë programe të reja në mënyrë që të furnizojnë ekonominë me profesionistë që të shtojnë cilësinë e shërbimeve ose produkteve që ato biznese ofrojnë. Këto programe të reja duhet të futen pas një analize të tregut të punës që identifikon bizneset në zhvillim që kanë nevojë për profesionistë nga fusha e bujqësisë.

Objektivi 1: Zhvillimi i dy programeve të reja Bachelor deri në vitin 2021

Me programet aktuale, FBV pranon rreth 540 studentë çdo vit. Ka pasur një kërkesë në rritje për programet e studimit të bujqësisë dhe veterinarisë. Me kapacitetet aktuale, dhe me parashikime reale për 5 vitet e ardhshme, FBV beson se mund të krijohen të paktën edhe dy programe të reja Bachelor. Gjithashtu, njëri nga programet akademike duhet të bëhet në gjuhën angleze me qëllim të ofrimit të qasjes edhe për studentët ndërkombëtar si dhe stafi akademik ndërkombëtarë.

Strategjia 1: Bashkëpunimi me IBV-në dhe Qendrën për Përsosmëri në Mësimdhënie (QPM) për të hulumtuar rreth potencialit të çdo programi studimor.

Fakulteti do të punojë me IBV-në dhe QPM-në për të krijuar një plan pune / ekip që do të udhëheqë procesin e hartimit të kurrikulës në përputhje me nevojat e tregut.

Veprimet:

- a. Aplikimi për financim të jashtëm nga organizata ndërkombëtare për ridizajnimin e kurrikulumit dhe projekteve hulumtuese që kanë për qëllim ridizajnimin e kurrikulave;
- b. Krijimi i partneriteteve të reja dhe zhvillimi me partneritetet ekzistuese për të ndihmuar në hartimin e kurrikulave që përfshijnë qasje interdisiplinare në këto kurrikula;

Strategjia 2: Përcaktimi i nevojës së fuqisë punëtore nga studimet e tregut të punës.

Veprimet:

- c. Aplikimi për fonde të jashtme për të kryer hulumtime në tregun e punës;
- d. Përmes institutit ose një pale të tretë, FBV do të kryejë studime të tregut të punës në mënyrë që të kuptojë se ku ka kërkesa për programe të reja.

Objektivi 2: Zhvillimi i 3 programeve të reja Master deri në 2022

Trendet bashkëkohore po përqendrohen në bujqësi të qëndrueshme dhe Kosova duhet të fillojë sa më herët, në mënyrë që të jetë në gjendje të ofrojë hulumtime dhe politika kur bëhet fjalë për bujqësinë e qëndrueshme. Programet Master duhet të plotësojnë hendekun mes nevojës në rritje të shpejtë për ekspertizë profesionale në industrinë e fundit të avancimeve të bujqësisë dhe të shëndetit publik veterinar.

Deri në vitin 2019 planifikohet akreditimi i programit master “Një Shëndet”. Gjithashtu, njëri nga programet akademike duhet të bëhet në gjuhën angleze me qëllim të ofrimit të qasjes edhe studentët ndërkombëtare si dhe stafi akademik ndërkombëtarë.

Strategjia 1: Krijimi i grupit punues për “Projektet e Sponsorizuara”

Veprimet:

- e. Targetimi i fondeve ndërkombëtare përmes IBV-së që synojnë të sponsorizojnë hulumtime dhe projekt-propozime në fushën e bujqësisë dhe veterinarisë;
- f. Krijimi i grupeve punuese për të hulumtuar potencialin në fusha të ndryshme duke pasur parasysh kapacitetet reale njerëzore të FBV-së;
- g. Krijimi i partneriteteve strategjike me universitete të tjera që mund të ofrojnë mundësi mentorimi për profesorët dhe studentët e FBV-së;
- h. Krijimi i grupeve punuese ndërdisiplinore me fakultetet tjera që vlerësohen si partnerë strategjik, si fakulteti i biologjisë, kimisë, inxhinierisë, mjekësisë e të

tjera;

Objektivi 3: Krijimi i dy programeve ndërdisiplinore të PhD.

Strategjia 1: Prodhimi i një hulumtimi të detajuar në lidhje me fushën që do të kishte ndikim më të lartë të mundshëm të studimit për një program PhD.

Veprimet:

- i. Bashkërendimi me të gjitha departamentet për të caktuar temat e projekteve kërkimore për studentët në programet master për të prodhuar dokumente që përqendrohen në nevojën për programe specifike të doktoratës bazuar në nevojat e tregut / çështjet aktuale për FBV dhe lidhur me fakultetet e tjera;
- j. Kryerja e vlerësimit të brendshëm që tregon burimet e për të krijuar programin e doktoratës.

Qëllimi 3: Rekrutimi i stafit të shkëlqyeshëm dhe produktiv

Objektivi 1: Punësimi i së paku 10 profesorëve me orar të plotë deri më 2021.

Me numrin aktual të stafit, nuk është e mundur të përmirësohet ndjeshëm cilësia e edukimit, të rriten kapacitetet kërkimore dhe të sigurohet një kontribut kuptimplotë për komunitetin. Profesorët janë të mbingarkuar me klasa (orë), me pak kohë të mbetur për hulumtime (kërkime). Një minimum prej 10 profesorëve dhe asistentëve të rinj me orar të plotë deri në vitin 2021 do të përmirësonte ndjeshëm cilësinë e edukimit dhe do të rriste kapacitetet kërkimore.

Strategjia 1: Punësimi i të paktën 2 profesorëve asistentë të rinj çdo vit deri në vitin 2022.

Duke marrë parasysh burokracinë e punësimit të stafit të ri në Universitetin e Prishtinës, duhet të ketë një listë prioritare për profesorët e rinj brenda FBV-së për të koordinuar më mirë rekrutimin e stafit të ri. Kjo pjesë e strategjisë duhet të

konsiderohet me prioritet të lartë, duke marrë parasysh gjatësinë e procedurave për angazhimin e anëtarëve të rinj të stafit.

Veprimet:

- a. Organizimi i takimeve me nivelin qendror të UP-së dhe adresimi i kësaj çështje me prioritet të lartë;
- b. Përcaktimi i prioriteteve të brendshme për punësimin e stafit të ri, duke i dhënë përparësi departamenteve dhe programeve që kanë një numër më të madh studentësh, kanë shkallë më të lartë të punësimit pas diplomimit dhe ku profesorët e mbingarkuar përbëjnë shumicën krahasuar me departamentet e tjera përkatëse;
- c. Organizimi i takimeve me të gjitha departamentet në mënyrë që të kontrollohen anëtarët e mbingarkuar të stafit dhe kurset e tyre. Këto takime duhet të përdoren për të bashkërenduar prioritetet së bashku. Kjo duhet të bëhet menjëherë pas vlerësimit të brendshëm, pasi që çdo propozim për anëtarët e rinj të stafit duhet të propozohet në Këshillin e Fakultetit së pari dhe duhet të votohet aty, para se të dërgohet për miratim në menaxhmentin qendror të UP-së (Rektorat). Prandaj, një koordinim paraprak i departamenteve të FBV-së është i nevojshëm për të zbatuar me sukses këtë strategji;
- d. Puna me fakultete të ndryshme për të shqyrtuar mundësitë e potencialit ndërdisiplinor të programeve. Për shembull, nëse do të planifikohen kurse të tilla si Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit në Bujqësi, këto kurse mund të organizohen së bashku me Fakultetin Teknik të UP-së;
- e. Kryerja e një vlerësimi të brendshëm për ngjashmëritë e lëndëve mësimore të ofruara brenda departamenteve të ndryshme. Në rastet e ngjashmërive, një kurs mund të ofrohet për studentët e departamenteve të ndryshme në të njëjtën kohë;

- f. Zhvillimi i një plani mentorimi për asistentët - profesorët e rinj që do t'i bashkohen FBV-së deri më 2020. Ky komitet duhet të përbëhet nga profesorë aktual me përvojë nga FBV-ja që do të mbështesin dhe udhëzojnë anëtarët e rinj të stafit;

Strategjia 2: Deri më 2022, çdo profesor duhet të ketë së paku një asistent.

Përveç profesorëve, asistentët janë të mbingarkuar me një numër të madh kursesh (orësh) për person. Përveç kësaj, ligjërimi i llojeve të ndryshme të kurseve në të njëjtën semestër ndikon në cilësinë e mësimdhënies. Për më tepër, lëndët e caktuara (orët) për asistentë ndryshojnë nga viti në vit.

Veprimet:

- g. Organizimi i takimeve në nivelin e Fakultetit për të përcaktuar prioritetet për çdo departament;
- h. Rritja e numrit të asistentëve për çdo departament - të paktën një pozitë më shumë për çdo departament deri në vitin 2020, poashtu me qëllimin që të përshtatet me strategjinë që secili profesor duhet të ketë së paku një asistent deri në vitin 2022;
- i. Çdo kurs që është planifikuar në sistemin e Bolonjës (2 + 2), 2 orët e destinuar për asistentë duhet të mbahen mundësisht nga asistentët përkatës të lëndës;
- j. Zhvillimi i një plani të lëndeve, ku secili asistent do të mbajë të njëjtën lëndë gjatë viteve. Ky plan krijon një mundësi për asistentët që të rrisin ekspertizën e tyre për lëndë të veçanta;
- k. Zhvillimi i një plani mentorimi dhe zhvillimi për asistentët, ku secili asistent do të ketë mundësi të përparojë në pozicionin asistent profesor pasi të plotësohen kërkesat ligjore për avancim;

- I. Monitorimi dhe vlerësimi për asistentët duhet të kryhet në baza të rregullta (për shembull - bazuar në kohëzgjatjen e kontratës);

Strategjia 3: Rritja e numrit të teknikëve të laboratorëve dhe rritja e volumit të punës nëpër laboratorë.

Taktikat:

- m. Angazhimi i të paktën 3 teknikëve të rinj me kohë të pjesshme deri në vitin 2020;
- n. Aplikimi në organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që financojnë projekte të ndryshme që fakulteti mund të implementojë dhe përfshijë teknikë të laboratorit në stafin e projekteve. Në fillim, pagat e këtyre anëtarëve të rinj të stafit do të jenë të bazuar në projekte. Nëse është e nevojshme, numri mund të rritet pas vitit 2020. Teknikët e rinj të laboratorit mund të punësohen nga instituti i FBV-së në një fazë të mëvonshme;
- o. Përfshirja e kostove të punës laboratorike në propozimet e projekteve kërkimore. Këto shpenzime duhet të planifikohen me kujdes për të mbajtur një aktivitet të rregullt kërkimor të laboratorëve në FBV;
- p. Përdorimi i potencialit të IBV-së për të kryer shërbime që do të gjenerojnë të ardhura të mjaftueshme për të angazhuar teknikë të laboratorit dhe për të mbuluar kostot operacionale të laboratorëve ekzistues. Krijimi i hapësirave të nevojshme duke përfshirë klinikat e nevojshme dhe laboratorët duke i plotësuar u referuar në rregulloren e BE-së për funksionim të institucioneve që ofrojnë edukim universitar në Mjekësi Veterinare;
- q. Kryerja e një vlerësimi të brendshëm në lidhje me kapacitetet aktuale të teknikëve të angazhuar. Nëse vlerësimi gjen se numri i teknikëve është i vogël, duhet të rritet numri i tyre bazuar në planet e financimit që FBV-ja së bashku me IBV-në do të zhvillojë;

Objektiva 2: Administratë efikase deri më 2022

Strategjia 1: Së paku 50% e detyrave aktuale të administratës (shërbimeve) duhet të digjitalizohen deri më 2022.

Sistemi aktual i administratës bazohet në përdorimin e kufizuar të kompjuterëve. Shumica e detyrave që kryhen aktualisht nga stafi i administratës kryhen me një përdorim të kufizuar të teknologjisë. Prandaj, përdorimi i Teknologjisë së Komunikimit dhe Informacionit në një përqindje më të lartë do të rrisë performancën e administratës së FBV-së. Përdorimi i TIK-ut nga administrata do të rrisë transparencën dhe llogaridhënien, duke rezultuar në një shpërndarje efikase të shërbimeve për palët përkatëse të FBV-së.

Veprimet:

- r. Krijimi i një liste të kërkesave më të shpeshta në administratë nga studentët dhe personeli i FBV-së;
- s. Krijimi i një liste të dokumenteve më të zakonshme të kërkuara nga studentët;
- t. Digjitalizimi i shumicës së këtyre kërkesave duke eliminuar nevojën për të vizituar administratën për kërkesa të zakonshme;
- u. Ngritja e një orari pune të rregullt ku dokumentet që lëshohen nga administrata mund të merren nga studentët dhe personeli i FBV-së;
- v. Përdorimi i pajisjeve të TI-së në administratë për të ofruar shërbime më të shpejta dhe më cilësore, që do të rrisin efikasitetin e këtij segmenti të rëndësishëm të fakultetit. Për shembull, studentët mund të dërgojnë dhe shkarkojnë dokumente të rëndësishme nëpërmjet faqes së internetit të Fakultetit (ose nëpërmjet SEMS-it), pa pasur nevojë të vizitojnë fizikisht administratën;

- w. Kërkesat e studenteve duhet të bëhen online nëpërmjet faqes së internetit të FBV-së ose SEMS-it;
